



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2237 prot.

Pukë, më 21.11.2023

PROJEKT VENDIM

Nr. 15 Datë 21.11.2023

PËR PROPOZIM KOMISIONIT QENDROR TE STATUSIT "DËSHMOR I
ATDHEUT" PËR SHPALLJE "DËSHMOR I ATDHEUT", TE NDJERIN SADIK
MURAT CINA"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", ligjit nr. 109/2018 "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", neni 5, pika a), neni 8, pika 1), neni 10, pika 6, neni 11, si dhe VKM nr. 151, datë 25.04.2002 "Për statusin Dëshmori Atdheut", I ndryshuar; si dhe pas shqyrtimit në komisionin këshillimor të vlerësimit të figurave:

VENDOSI

1. T'i propozojë Komisionit Qendror të Statusit "Dëshmori i Atdheut", shpalljen "Dëshmori i Atdheut", të të ndjerit Sadik Murat Cina, me motivacion:
"Për veprimtarinë e tij patriotike në mbrojtje të interesave kombëtare, si luftëtar kundër pushtimit dhe copëtimit të Shqipërisë në dy luftërat botërore".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Rrok DODAJ

Në mungesë dhe me urdhër

ZV. KRYETARI
Ferit RINGAJ



Drejtori I Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Sokol GJONI

Juristi
Aida SINANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 9237/prot.

Pukë, më 24.04. 2023

RELACION

Mbi

Projekt-vendimin për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”,

Z. Sadik Murat Cina

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5, pika a), neni 8, pika 1), neni 10, pika 6 dhe neni 11, si dhe VKM nr. 151, datë 25.04.2002 “ Për statusin Dëshmor i Atdheut”, i ndryshuar: *relatojmë si më poshtë:*

Projekt vendimi për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, i të ndjerit Z. Sadik Murat Cina, drejtuar Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, paraqitet para jush, me propozim të disa intelektualëve, historianëve dhe Organizatës së Dëshmorëve, dega Pukë,

Nisur nga sa më sipër, dhe në njohje të dokumentacionit të paraqitur për veprimtarinë e tij në mbrojtje të interesave kombëtare, ju ftoj të votoni projekt-vendimin për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, të ndjerit Z. Sadik Murat Cina, të paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Bashkëlidhur:

- ✓ Projekt-vendimi “Projekt vendimi për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, Z. Sadik Murat Cina.”
- ✓ Dosja me dokumentacionin njohës mbi jetën dhe veprën e z. Sadik Murat Cina.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni